



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/57

Datë: 13.01.2021

Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4 dhe të nenit 93, paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 37 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores (QRK) - Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) - Nr. 07/2020, si dhe në nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur me 13.01.2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për emërimin e z. Samedin Mehmeti Drejtor të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës.
2. I rekomandohet Kryeministrit të Republikës së Kosovës që të emërojë z. Samedin Mehmeti Drejtor të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/57

Datë: 13.01.2021

Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2020, si dhe në nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke iu referuar kërkesës së Ministrisë së Punëve të Brendshme me nr. prot. 4462 të datës 29.12.2020, në mbledhjen e mbajtur me datë 13.01.2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme për përjashtim nga fushëveprimi i Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, për Projektin "Sistemi i Sigurisë së Rrjetit dhe të Dhënave".
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë